

VENDIM
Nr.775, datë 24.9.2010

PËR ADMINISTRIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 39 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 26 të ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sigurimi dhe administrimi i financimeve të huaja, si pjesë përbërëse dhe/ose e raportuar në sistemin buxhetor të Republikës së Shqipërisë, është objekt i këtij vendimi.

2. Financime të huaja janë të gjitha huat, kreditë dhe grantet që merr Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë nga shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, organizatat joqeveritare etj.

3. Marrëveshje qeveritare kuadër janë marrëveshjet/protokollet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e bashkëpunimit financiar apo bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve.

4. Marrëveshje qeveritare janë marrëveshjet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e financimit të projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.

5. Marrëveshje financimi janë marrëveshjet e huas/kredisë apo grantit që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kreditorëve ose donatorëve të huaj, për financimin e projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.

6. Mbështetur në analizën dhe vlerësimin e situatës ekonomike e financiare të vendit, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, miraton çdo vit programin buxhetor afatmesëm (PBA), si pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar (SPI). Programi buxhetor afatmesëm parashikon tërësinë e projekteve të investimeve publike, përfshirë edhe ato me financime tërësisht të huaja ose bashkëfinansim me buxhetin e shtetit, për çdo program, në një periudhë trevjeçare.

7. Koordinimi i projekteve me financim të huaj bëhet në përputhje me procedurat e sistemit të planifikimit të integruar (SPI), miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave. SPI-ja është kuadri kryesor kombëtar për hartimin e politikave dhe planifikimin financiar, përcaktimin e përparësive strategjike të zhvillimit dhe integritit të vendit dhe alokimin e burimeve të brendshme e financimeve të huaja, në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar.

8. SPI-ja, nëpërmjet kuadrit strategjik, në bazë të të cilit përcaktohen përparësitë për financim të huaj, bazohet në përparësitë e programit të qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, të përditësuar, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe planit kombëtar për zbatimin e MSA-së.

9. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit, koordinon procesin e identifikimit, diskutimit dhe përzgjedhjes së përparësive strategjike duke u këshilluar me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore të pavarura.

10. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përmes mekanizmave dhe procedurave të përcaktuara në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), orienton programet afatgjata dhe afatmesme të financimeve të huaja dhe miraton listën e projekteve të reja parësore, për çdo sektor. Lista e projekteve parësore, e miratuar në parim, nga KPS-ja, do të përdoret në vijimësi nga Ministria e Financave dhe DEBASKON-i, në negociatat me huadhënësit/dhuruesit, për financime të reja.

11. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që ka të drejtë të kërkojë dhe të sigurojë financime nga huadhënësit dhe dhuruesit, në formën e huave dhe granteve, që janë bashkëfinancim me hua. Në rastet e sigurimit të financimeve vetëm me grant ose kur granti është bashkëfinancim me fonde buxhetore, ky proces kryhet nga DEBASKON-i në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit.

12. Përgjegjësitë e institucioneve për ndjekjen e procedurave për përfundimin e marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, janë si vijon:

a) Për marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit, Ministria e Financave dhe DEBASKON-i janë, përkatësisht, palë kryesore në negociata, në varësi të llojit të financimit, me hua apo grant. Në grupin e negocimit marrin pjesë edhe përfaqësues të ministrive përkatëse të linjës.

b) Për marrëveshjet qeveritare, procesi i negocimit udhëhiqet nga DEBASKON-i, i cili bashkëpunon me ministrinë e linjës dhe Ministrinë e Financave. Nga kjo pikë bën përjashtim negocimi i financimeve nga Programi i Asistencës së Paraaderimit (IPA) nga BE-ja, proces, i cili udhëhiqet nga Ministria e Integritit.

c) Pas negocimit, Ministria e Financave në bashkëpunim me DEBASKON-in, paraqesin për miratim në parim në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare kuadër të negociuara.

ç) Pas negocimit, ministrinë e linjës përfituese, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, paraqesin për miratim në parim, në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare dhe marrëveshjet e financimit të negociuara.

d) Ministri i Financave, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruan marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit.

dh) Ministrat përkatës të linjës, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruajnë marrëveshjet qeveritare.

13. Institucionet përfituese (qendrore dhe vendore), janë përgjegjëse për të parashikuar në buxhetin e tyre të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse të financimit, të miratuara.

14. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, institucioni nënshkrues ndjek procedurat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve përkatëse.

15. Ministria e Financave dhe DEBASKON-i shkëmbejnë informacionin me huadhënësit/dhuruesit dhe përfituesit e financimeve të huaja lidhur me huat/grantet e marra, masën dhe destinacionin e përdorimit të tyre.

16. DEBASKON-i dhe Ministria e Financave mbikëqyrin ministrinë e linjës, për përmbushjen e kushteve të vendosura në marrëveshjet me huadhënësit dhe/ose dhuruesit dhe për progresin e bërë në zbatimin e projekteve përkatëse.

17. Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat dhe grantet. Ministrinë dhe institucionet qendrore e vendore janë të detyruara t'i raportojnë Ministrisë së Financave të gjitha të dhënat e kërkuara, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave dhe granteve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor.

18. Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura

në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuruesi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojë për këtë qëllim Ministria e Financave.

19. Shpenzimi i huave dhe granteve të livruara do të regjistrohet në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Transferimet në llogaritë e përfituesve kryhen nga llogaritë e sistemit të thesarit në bankat e nivelit të dytë. Kur huat dhe grantet livrohen në natyrë ose menaxhohen drejtpërdrejt nga dhuruesit, të regjistrohen në të njëjtën kohë si të ardhura (të hyra) në buxhet dhe si shpenzime (të dala), në bazë të njoftimit të pagesave të kryera për blerjen e mallrave ose shërbimeve përkatëse dhe konfirmimit të përfituesit.

20. Ministrinë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mosraportimi në kohë ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfituar.

21. Ministrinë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.

22. Brenda muajit janar dhe korrik të çdo viti, ministrinë e linjës i raportojnë DEBASKON-it për:

a) të dhënat për ecurinë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, për vitin pararendës;
b) të dhënat për planifikimin e zbatimit të projekteve me financime të huaja, për vitin në vazhdim. Kjo përfshin si projektet që kanë filluar në vitin pararendës, ashtu edhe ato për të cilat financimi është i garantuar dhe zbatimi i tyre pritët të fillojë gjatë vitit në vazhdim;

c) projektpropozimet për financime të huaja, për projekte që mund të diskutohen në negociatat me donatorët, gjatë vitit në vazhdim.

Për të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, ministrinë e linjës informojnë edhe Ministrinë e Integritit, për projektet me mbështetje financiare nga fondet e BE-së.

23. DEBASKON-i, si njësia përgjegjëse e ngarkuar me mbajtjen e bazës së të dhënave të financimeve të huaja:

a) përditëson bazën e të dhënave me informacionin e ardhur nga ministrinë e linjës brenda muajit mars dhe muajit shtator të çdo viti;

b) përgatit raportin vjetor të monitorimit të financimeve të huaja, për vitin pararendës.

24. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme lidhur me procedurat që duhen ndjekur gjatë fazave të ndryshme të livrimit, shpenzimit, raportimit dhe shlyerjes së kredive dhe granteve.

25. Ngarkohen Ministria e Financave, DEBASKON-i, Ministria e Integritit dhe ministrinë e linjës, si dhe institucionet e tjera në varësi të pushtetit ekzekutiv qendror për zbatimin e këtij vendimi.

26. Vendimi nr.116, datë 24.2.1997 i Këshillit të Ministrave “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe granteve të huaja, që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha